

VENDIM
Nr. 367, datë 15.12.2023

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ‘ALBGAZ’ SHA”, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të neneve 13, pika 1, 16, pika 2, 17, germa “e” dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2232/2 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, ‘Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a.’, për vitin 2024”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022, vendosi ndër të tjera: shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 2232 prot., datë 3.10.2023, i ka sjellë në vëmendje shoqërisë “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi. Kërkesë e cila duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin sipas metodologjisë përkatëse.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 118/1 prot., datë 7.11.2023, thekson se rrethanat në të cilat shoqëria “Albgaz” sh.a. zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si OST e gazit natyror, nuk ka pasur zhvillime domethënëse të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në elementet të cilat përcaktojnë metodologjinë e tarifës. Shoqëria “Albgaz” sh.a. kërkon që për vitin 2024 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022.

- Neni 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se: ERE, mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rast kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

- Duke pasur parasysh se Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albgaz” sh.a., që përmban investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë, si dhe vlerësohet se deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife transmetimi të gazit natyror, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206 datë 16.12.2019. Për arsye se tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria “Albgaz” sh.a., konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti